



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr.267, Datë 28.12.2020

“MBI  
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR TË MIRATUAR  
“KUSHTET PËR TE LICENCUARIN E NGARKUAR ME DETYRIMIN E  
SHËRBIMIT PUBLIK PËR SEKTORIN E GAZIT NATYROR” NË SHQIPËRI”

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit Nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; VKM nr. 533, datë 25.07.2019 “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e gazit natyror, të cilët ushtrojnë aktivitetin e transmetimit, të shpërndarjes dhe furnizimit me gaz natyror”; nenit 92, pika 3, të Ligjit Nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; si dhe nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.142/10 Prot, datë 24.12.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për të miratuar **“Kushtet për të licencuarin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për sektorin e gazit natyror” në Shqipëri.**

**Konstatoi se:**

- Në nenin 23, pika 1, germa f), të Ligjit nr. /2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, parashikohet se: *1. ERE përcakton kushtet që duhet të përmbushen për marrjen e një licence, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera: f) detyrimet e shërbimit publik, siç parashikohet në këtë ligj;*
- Në nenin 92, pika 3, në Ligjin 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” ERE përcakton dhe miraton rregullat operationale për furnizuesit që kryejnë furnizimin e gazit natyror si një detyrim të shërbimit publik. Furnizuesi i shërbimit publik duhet t’u ofrojë klientëve të cilët kanë të drejtën e shërbimit publik, shërbimin e furnizimit konform kontratës standarte të furnizimit të miratuar nga ERE në përputhje me Nenin 95, të Ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe legjislacionit përkatës për mbrojtjen e klientëve.
- Këshilli i Ministrave me VKM nr. 533, datë 25.07.2019 “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e gazit natyror, të cilët ushtrojnë aktivitetin e transmetimit, të shpërndarjes dhe furnizimit me gaz natyror”, përcakton kushtet dhe procedurat që duhet të ndiqen nga ERE për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, për të licencuarit

në sektorin e gazit natyror, të cilët ushtrojnë aktivitetin e transmetimit, të shpërndarjes dhe furnizimit me gaz natyror të klientëve të vegjël, përfshirë klientët familjarë.

- Siç përcaktohet në nenin 4, pika 4.1, të VKM nr. 533, datë 25.07.2019, detyrimi i shërbimit publik ndaj një të licencuari vendoset nga ERE, në përputhje me nenin 89, të ligjit 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, në mënyrë transparente, jodiskriminuese dhe lehtësisht të verifikueshme, duke garantuar barazinë e aksesit për shoqëritë e gazit natyror të vendeve anëtare të BE-së ose palë kontraktuese të Komunitetit të energjisë për klientët vendas dhe duke mos penguar hapjen e tregut të gazit natyror dhe të drejtën e furnizuesve të tjerë të gazit natyror për të furnizuar klientët në Republikën e Shqipërisë.
- Keto rregulla/kushte operationale për Furnizuesin e shërbimit publik FSHP me gaz natyror që i vendosen të licencuarit e ngarkuar me këtë detyrim nga ERE, janë përpiluar në përputhje me parimet e ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, me synimin arritjen e një tregu konkurrues, të sigurt e të qëndrueshëm, të gazit natyror, nga pikëpamja mjedisore, pa qenë të diskriminuar në të drejtat dhe detyrimet e tyre. Gjithashtu, janë marrë në konsideratë dhe Vendimi i bordit të ERE-s nr. 68, datë 22.04.2020 mbi miratimin e “Kodit të rrjetit të transmetimit të gazit natyror” dhe Vendimi i bordit të ERE-s nr.166, Datë 22.10.2020 për miratimin e “Kushteve të përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundor që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për të miratuar “Kushtet për të licencuarin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për sektorin e gazit natyror” në Shqipëri.
2. Drejtoria e Gazit natyror, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**